

NJOFTIM I PËRSËRITUR (7)

PËR MARRJEN ME QIRA TË PASURISË NGA TË TRETËT PËR USHTRIM AKTIVITETI DOGANOR NGA DEGA DOGANORE VLORË

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton të interesuarit/konkurrentët se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë doganore të Degës së Doganës Vlorë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - të jetë objekt ndërtimor me sipërfaqe minimalisht rrëth 500 m², e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë doganore
 - bazuar në funksionalitetet sipas përcaktiveve të legjislacioni doganor dhe specifikat e Degës Doganore Vlorë si doganë, kërkohet që vendodhja e ambienteve të jetë në territorin e brendshëm (ose pranë) Portit Detar sh.a Vlorë ;
 - Objekti te jetë i hipotekuar (dokumentacioni vërtetues të jetë i tre muajve të fundit) dhe të ketë një plan rilevimi të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar;
 - Nisur nga rëndësia e lartë e institucionit të jetë e përshtatshme për ruajtjen e sigurisë së ambjentit;
 - Në objekt të jetë i siguruar furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe në të, të ketë sistem ngrohje të instaluar;
 - Vlera fillestare e qirasë për konkurrim për njoftimin e katërt në zbatim të Udhëzimit Nr.08, datë 04.11.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së marrjes me qira, të pasurisë nga Degët Doganore", pika 16 "...Nëse procedura dështon dy herë radhazi..atëherë VFQ rritet deri ne 20 % nga VFQ e fundit, për çdo shpallje njoftimi deri në realizimin e procedurës" , merr vlerën:
$$VFQ = 184\,757.8 \text{ lekë(e mëparshme)} * 20\% = 221,709 \text{ lekë}$$
2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:
 - a. kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;
 - b. deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit, për veprimtari doganore;
 - c. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
 - d. formulari i sigurimit të ofertës në vlerën 2% të VFQ. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 100 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
 - e. vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka subjekti konkurrues. Mossħlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e konkurruesit, përvèç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.
 - f. NIPT/NUIS-i, certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
 - g. vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet

shoqërore;

- h. vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga konkurruesi, me mbishkrimin “*Ofertë për dhënie me qira*” dhe i dorëzohet KMQ në orën e hapjes së konkurrimit

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

3. Vendi i zhvillimit te konkurrimit: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zyra e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, me adresë: Rr. E Durrësit, Laprake, Tirane.
4. Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët fizikisht, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.
5. Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese: **02.08.2017**